



BASHKIA
TIRANË

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 29, datë 05.04. 2017

PËR

“ NJË SHITESË DHE DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK TË TIRANËS NR.84, DATË 29.12.2016, “PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2017-2019 DHE DETAJIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË SË TIRANËS PËR VITIN 2017(I NDRYSHUAR)”

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronja “b” e pika 1/1.3, shkronja “c”, nenit 34, pika 6, nenit 40, pika 4, nenit 41, pika 1, shkronja “c”, nenit 54, shkronja “dh” dhe nenit 55, pikat 3 dhe 6 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2016 për “Vetëqeverisjen Vendore”; nenit 39, paragrafi i fundit dhe nenit 44, paragrafi i dytë, shkronja “a” të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar); Ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; Ligjit nr. 7776, datë 22.12.1993 për “Buxhetin lokal” (i ndryshuar); Ligjit nr. 130, datë 15.12.2016 “Për Buxhetin e vitit 2017”; Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 2, datë 06.02.2012 për “Procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”(i ndryshuar); Udhëzimit plotësues të Ministrit të Financave nr.8 datë 13.01.2017 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2017”; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 84 datë 29.12.2016 për “Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2017-2019 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2017” (i ndryshuar), pas shqyrtimit të relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak;

V E N D O S I:

1. Të miratojë një shtesë në pikën 1.1 të vendimit të Këshillit Bashkiak të Tiranës nr.84, datë 29.12.2016, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2017-2019 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2017” në shumën **304,645,529** lekë, të përbërë nga:
 - a- Sipas akt-rakordimeve me Degën e Thesarit të Tiranës, fondet e mbartura nga të ardhurat e Bashkisë për vitin 2016 janë në shumën 922,049,053 lekë. Kësaj vlere i zbritet parashikimi i të ardhurave të trashëguara në shumën 650,000,000 lekë. Si rrjedhim shtesa e fondeve të mbartura nga viti 2016 nga të ardhurat e Bashkisë është në shumën 272,049,053 lekë.
 - b- shtesa e fondit të mbartur nga viti 2016 nga transferta e pakushtëzuar në shumën 32,596,476 lekë;
2. Të miratojë detajimin e fondeve të trashëguara nga viti 2016 në zbatim të pikës nr.1, sipas pasqyrës nr.1, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Të miratojë detajimin e fondeve të trashëguara nga transferta specifike e vitit 2016 si një shtesë në pikën 1.3 të vendimit të Këshillit Bashkiak të Tiranës nr.84, datë 29.12.2016, “Për

miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2017-2019 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2017”, sipas pasqyrës nr.2 dhe 2.1, pjesë përbërëse e këtij vendimi.

4. Të miratojë një shtesë në pikën 2-2.5 të vendimit të Këshillit Bashkiak të Tiranës nr.84, datë 29.12.2016, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2017-2019 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2017”, në shumën **2,914,102,113 lekë** të përbërë nga:
 - a- Fondet e mbartura për vitin 2016 nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve, në programin e Menaxhimit të Rrugëve dhe Transportit Publik, janë në shumën 1,853,485,176 lekë ndërsa fondet e akorduara për vitin 2017 janë në shumën 1,060,616,937 lekë, detajuar sipas pasqyrës nr. 3 pjesë përbërëse e këtij vendimi.
 - b- Fondet e akorduara për vitin 2017 nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve në programin e Arsimit janë në shumën 61,932,708 lekë, detajuar sipas pasqyrës nr. 3 pjesë përbërëse e këtij vendimi.
5. Të miratojë rishpërndarjen e fondeve ndërmjet programeve të Shërbimeve Publike, Programit të Menaxhimit të Rrugëve dhe Transportit Publik, Programit të Arsimit, Programit të Kujdesit Social, Programit Planifikim, Manaxhim, Administrim, Programit të Strehim Planifikim Territorit dhe Programit të Turizmit e Kulturës sipas pasqyrave nr.4,5,7,8,9,11,12 pjesë përbërëse e këtij vendimi.
6. Të miratojë detajimet e fondeve ndërmjet programeve të Shërbimeve Publike dhe Programit të Strehim Planifikim Territorit sipas pasqyrave nr. 6 dhe 10, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licensimit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Përgjithshme e Promovimit të Qytetit, Drejtoria e Përgjithshme e Projekteve Strategjike, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria e Përgjithshme e Komunikimit dhe marrëdhënieve me Publikun, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësisve Administrative dhe Emergjencave Civile dhe ndërmarrjet në varësi të Bashkisë së Tiranës.
8. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI

